

| Emri i Lëndës : Gjuhë Shqipe I |   |  |                     |                     |                |         |      |
|--------------------------------|---|--|---------------------|---------------------|----------------|---------|------|
| Kodi                           | Tipi  | Semestri   | Leksione (orë/javë) | Seminare (orë/javë) | Lab (orë/javë) | Kredite | ECTS |
| ALB 101                        | B   | Vjeshtë  | 4.00                | 0.00                | 0.00           | 4.00    | 5.00 |
| <b>Lektori</b>                 |   | Loreta Loli, PhD   |                     |                     |                |         |      |
| <b>Asistenti</b>               |   |  |                     |                     |                |         |      |
| <b>Gjuha e kursit</b>          |   | Anglisht   |                     |                     |                |         |      |
| <b>Niveli i lëndës</b>         |   | Bachelor   |                     |                     |                |         |      |
| <b>Përshkrimi</b>              |   | Gjuha është një element shumë qendror në jetën e njeriut. Ajo ndihmon si realizimin e komunikimit, ashtu edhe formësimin e mendimit dhe transmetimin e tij. Për këtë arsye, një përdorim i saktë dhe sa më i mirë i gjuhës na ndihmon si në procesin e njohjes, ashtu edhe në vetë prezantimin e personalitetit tonë. Ky kurs synon t'i aftësojë studentët me një përdorim korrekt dhe sa më të mirë të shqipes, të përmirësojë aftësitë e tyre në shkrimin e shqipes dhe t'i ndihmojë në ndërtimin e një ligjërimi të rrjedhshëm.   |                     |                     |                |         |      |
| <b>Objektivat</b>              |   | <ul style="list-style-type: none"> <li>•Të njihet dhe të aftësohet praktikisht studenti me rregullat themelore të artit të të shkruarit.</li> <li>•Të përvetësohen çështje të normës morfologjike dhe sintaksore.</li> <li>•Të arrijnë studentët një akt të lartë komunikativ, nëpërmjet ligjëritimit normativ.</li> <li>•Të bëjnë punime me nivel të lartë gjuhësor (ese, detyra kursi dhe punim diplome).</li> <li>•Të nxitet të vështruarit kritik dhe akti i korrektimit në rastet e devijimeve nga shqipja standarde.</li> </ul>  |                     |                     |                |         |      |
| <b>Konceptet Kryesore</b>      |   | 1. shkrimi i krijimit; teksti; koherenca, kohezioni 2. rishikimi i materialit: redaktimi, korrektimi 3. gjuha standarde, pastërtia e leksikut, shmangiet nga standardi 4. supletiviteti i foljeve (të parregullta; dysorët) ... etj. Pas përfundimit të skedimit të literaturës së planifikuar, pasi lexojmë skedat me mendime të vjela, fillojmë nënvizimin dhe shënimet, bëjmë sistemimin në përputhje me planifikimin e bërë më herët. Çdo shkrim përbëhet nga hyrja, zhvillimi dhe përfundimet. Lidhen të trija pjesët në mënyrë të natyrshme, sepse ligjërimi duhet të jetë i lidhur. Formohet kështu paragrafi, që më shtëpesh lidhet me të tjerë, duke formuar njësinë që quhet tekst. Qoftë paragraf, artikull apo një libër i tërë ka kohezion dhe koherencë, që lidhen me organizimin gramatikor dhe atë logjik. |                     |                     |                |         |      |
| Programi i Lëndës              |   |  |                     |                     |                |         |      |
| Java                           | Tema  |  |                     |                     |                |         |      |
| 1                              | Kulturë gjuhësore: Arti i të shkruarit. - Rregulla të krijimit, fazat, planifikimi, shkrimi i krijimit, teksti, lidhëzat e tekstit. Shqipja letrare Gjithsecili mund dhe duhet të shkruajë, por kjo nuk është e lehtë, sepse duhen njohur dhe përvetësuar rregullat e krijimit gjuhësor, fazat, planifikimi që të krijohet teksti. Memushaj, Rami. (2002) Shqipja standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë Toena, Tiranë: 11-13.    |  |                     |                     |                |         |      |
| 2                              | Kulturë gjuhësore: Arti i të shkruarit. - Rregulla të krijimit, fazat, planifikimi, shkrimi i krijimit. Teksti, lidhëzat e tekstit. Të shkruash do të thotë të jesh krijues. Brenda rregullave duhet bërë kujdes për fazat e krijimit, planifikimin e tij, shkrimin, hartimin e tekstit, gjithnjë sipas kriterëve të gjuhës standarde. Memushaj, Rami. (2002) Shqipja standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë Toena, Tiranë:14-30. |  |                     |                     |                |         |      |
| 3                              | Rishikimi: rishkrimi, redaktimi dhe korrektimi. Redaktimi. Korrektimi. Shenjat e korrektimit Pas shkrimit me dorë të parë, fillon rishikimi i materialit, që do të thotë rishkrim, redaktim dhe korrektim, yë shoqëruara me shenjat gjegjëse. Memushaj, Rami. (2002) Shqipja standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë Toena, Tiranë:33-40.  |  |                     |                     |                |         |      |

|    |  |
|----|--|
| 4  | Norma gramatikore. Gjuha standarde shqipe. Normat e shqipes standarde. Shprehitë e të shkruarit drejt. Kujdesi kryesor duhet të bëhet për njohjen dhe përvetësimin e normave gramatikore, që të forcohen shprehitë, aq të domosdoshme për ta kthyer gjuhën në mundësitë e saj reale. Memushaj, Rami. (2002) Shqipja standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë Toena, Tiranë:41-50.  |
| 5  | Gjinia, trajta dhe rasa e emrit. Do të shihen rastet kur emrat mashkullorë ndërrojnë gjininë në numrin shumës, emrat me të temë të njëjtë për të dyja gjinitë, trajtat dhe përdorimi i emrave të përveçëm. Kujdes duhet bërë për shumësin me prapashtesa dhe ndërrime. Memushaj, Rami. (2002) Shqipja standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë Toena, Tiranë:51-70.  |
| 6  | Përemri. Llojet. Kuptimi, veçoritë gramatikore. Ndryshime dhe ngjashmëri. Llojet e përmemrave, trajtat e shkurtra te përemri vector, mungesa e rasës gjinore, përemri pyetës, pronor, vetvector dhe ai lidhor. Memushaj, Rami. (2002) Shqipja standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë Toena, Tiranë:71-80.  |
| 7  | Folja. Klasat e foljeve. Prejardhja e formave foljore. Folje me dysorë. Mënyra urdhërore. Foljet me temë më zanore, klasa e parë, nënklasat, klasa e dytë dhe nënklasat. Foljet me temë më bashkëtingëllore dhe dy klasat e tij, bashkë me nënklasat. Foljet e parregullta, supletiviteti. Memushaj, Rami. (2002) Shqipja standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë Toena, Tiranë:81-98.  |
| 8  | Provim gjysmëfinal (MIDTERM).  |
| 9  | Rendi i gjymtyrëve në fjali. Rendi i përcaktorëve të një emri. A. Mbiemër + mbiemër; B. Mbiemër + numëror rreshtor ose përemër; C. Mbiemër +emër; D. Emër + emër. Ky kapitull, V, merr frymë nga citati-porosi i Nobert Joklit, që këshillon të ruhet shpirti i gjuhës shqipe nga çdo bastardim, sepse po futen në ligjërim gjedhe të huaja të panevojshme. Memushaj, Rami. (2002) Shqipja standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë Toena, Tiranë: 99-100.   |
| 10 | Përshtatja e gjymtyrëve në fjali Rendi, përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën në numër,, në vetë; përshtatja e përcaktorëve me emrin, në gjini, numër. Ndërtime shqipe në vend të ndërtimeve të huaja. Nëse kryefjala është emër përmbledhës, kallëzuesi vihet zakonisht në njëjës: Gjithë fshati u shkul për të parë shenjën e keqe. Kur kryefjala përbëhet nga disa përemra vetash të ndryshme, njëjës apo shumës, folja vihet në shumës. Përshtatje ka në vetë,, kryesisht kryefjala. Përcaktorët përshtaten në gjini, në numër. Memushaj, Rami. (2002) Shqipja standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë Toena, Tiranë:103-105.  |
| 11 | Përshtatja e kohëve në periudhën me nënrenditje Përshtatja varet nga lloji i fjalive, por edhe nga semantika (kuptimi) i vetë foljes; do të qëndrohet te rasti i përshtatjes së gabuar. Rregullat e përshtatjes së kohëve të foljes janë të shumta: varen nga lloji i fjalive, por edhe nga semantika e vetë kohëve të foljes. Në periudhën me nënrenditje, urdhërorja, koha e tashme, koha e kryer dhe koha e ardhme shoqërohen me njëra-tjetrën. Këtu ka raste kur ligjërimi i folur, ndërron me atë të shkruar. Memushaj, Rami. (2002) Shqipja standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë Toena, Tiranë: 106-107.   |
| 12 | Pastërtia e leksikut Bjerrja e kujdesit për gjuhën na kujton porosinë e albanologut Norbert Jokl: "Në qoftë se për të gjitha gjuhët çështja e pastërtisë së gjuhës është me rëndësi të madhe, për gjuhën shqipe ajo ka rëndësi jetësore." Problem krijojnë huazimet e panevojshme, kur dihet që shqipes nuk i mungojnë fjalët e brumit të vet. Por pasuria leksikore duhet njohur. Memushaj, Rami. (2002) Shqipja standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë Toena, Tiranë:  |
| 13 | Miqtë e rremë (gr. παρόνιμ- paronimet)... Shënitime gjuhe Paronimet janë çifte fjalësh të ngjashme në shkrim dhe shqiptim, po të ndryshme nga kuptimet. Shëntimet e gjuhës i krijojnë shqiptimi apo përdorimi i gabuar. Do të qëndrohet edhe te ndërtimet foljore të huaja. Memushaj, Rami. (2002) Shqipja standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë Toena, Tiranë:111- 115.  |
| 14 | Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj: Ushtrime Të shprehurit akademik: Konsultime (Prezantimet; Prezantimi gojor i punimit; Teknikat e të folurit në publik; Përdorimi i mjeteve elektronike dhe ndihmëse gjatë prezantimit; Prezantimi në grup; Si t'u përgjigjemi pyetjeve.) Në faqen 116-124 janë dhënë fjalë shqipe që mund të zëvendësojnë fjalën e huaj, e futur arbitrarisht në shqipe. Të shprehurit akademik ilustron konkretisht me shembuj, si duke prezantuar punimin, kujdesi për të folurit në publik, përdorimi i projektorit , smartboardit. Punohet edhe në grup dhe shihet sesi duhet të përgjigjesh. Memushaj, Rami. (2002) Shqipja standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë Toena, Tiranë:116-124. |
| 15 | Përsëritje. Ushtrime Për përforsim, në tekst janë dhënë 23 (fq. 125-132) ushtrime që i shërbejnë shtimit dhe përforsimit të shprehive gjuhësore. shërbejnë përsëritjes dhe përforsimit të njohurive dhe shprehive. Memushaj, Rami. (2002) Shqipja standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë Toena, Tiranë:125-132.  |

|  |   |
|--|---|
| <b>16</b>                                  | Provim Final  |
| <b>Parakushtet</b>                         | Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.  |
| <b>Literatura</b>                          | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rami Memushaj, Hyrje në gjuhësi, Tiranë, 2004 (botim i dytë).</li> <li>• Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980: fjalori.shkenca.org; Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë, 1984; Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006.</li> <li>• Ali Dhrimo-Rami Memushaj, Fjalor Drejtshkrimor i Gjuhës Shqipe, INFBOTUES, Tiranë, 2015.</li> <li>• Rami Memushaj, Shqipja standarde, Toena, Tiranë, 2002; Hyrje në gjuhësi, Dituria, Tiranë, 2004.</li> <li>• Cikël leksionesh nga lektori i lëndës. (Ky cikël leksionesh është hartuar duke u bazuar si në literaturën e detyrueshme, ashtu edhe në atë të këshillueshme, pra është një përmbledhje e koncepteve themelore të lëndës).</li> <li>• AShSh-Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë (IGjL), (2002, Ribotim), Rregullat e pikësimiit në gjuhën shqipe, Shtëpia botuese "Shkenca", Tiranë.</li> </ul> |
| <b>Referenca të tjera</b>                  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vangjush Ziko, Korça Qyteti dhe kujtime, Korçë, 2012, f: 350-396.</li> <li>• Hajri Shehu, Studime për leksikon..., Botimet Albanologjike, Tiranë, 2015.</li> <li>• Robert Elsie, Historia e letërsisë shqiptare,</li> <li>• Shaban Demiraj, Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe, Shtëpia botuese "Shkenca", Tiranë, 1999; Gjuha shqipe dhe historia e saj, Tiranë: SHBLU, 1988, f. 247-276.</li> <li>• Gjovalin Shkurtaç, Kultura e gjuhës, Tiranë: SHBLU 2006.</li> </ul>   |
| <b>Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat</b> |   |
| <b>1</b>                                   | Studentët do të pajisen me njohuritë bazë të gjuhës dhe do të dinë të shkruajnë pa gabime drejtshkrimore.   |
| <b>2</b>                                   | Studentët do të mund të përkthejnë më mirë nga gjuhët e huaja tekste të ndryshme, duke njohur në mënyrë rrënjësore gjuhën amtare.   |
| <b>3</b>                                   | Studentët do të arrijnë të shkruajnë ese, njoftime, deklarata etj., në mënyrë koherente dhe të saktë.   |
| <b>4</b>                                   | Do të përvetësohen çështjet gjuhësore që dalin prej shmangieve nga norma morfologjike dhe sintaksore.   |
| <b>5</b>                                   | Studentët do të arrijnë një akt të lartë komunikativ, nëpërmjet ligjërimit normativ.  |
| <b>6</b>                                   | Do të nxitet të vështruarit kritik dhe akti i korrektimit në rastet e devijimeve nga shqipja standarde.   |

| <b>Mënyra e Vlerësimit të Lëndës</b>   |              |                          |                              |
|--|--------------|--------------------------|------------------------------|
| <b>Notat e Ndërmjetme</b>  | <b>Sasia</b> | <b>Përqindja</b>         |                              |
| Gjysmë finale  | 1            | 40                       |                              |
| Kuize  | 0            | 0                        |                              |
| Projekte   | 0            | 0                        |                              |
| Projekte semestrare  | 0            | 0                        |                              |
| Punë laborator   | 0            | 0                        |                              |
| Pjesëmarrja në mësim   | 1            | 10                       |                              |
| <b>Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final</b>                            |              | <b>50</b>                |                              |
| <b>Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final</b>                                  |              | <b>50</b>                |                              |
| <b>Total</b>   |              | <b>100</b>               |                              |
| <b>Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)</b>                                 |              |                          |                              |
| <b>Aktivitetet</b>   | <b>Sasia</b> | <b>Kohëzgjatja (orë)</b> | <b>Ngarkesa Totale (orë)</b> |
| Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit) | 16           | 4                        | 64                           |
| Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)                              | 14           | 4                        | 56                           |
| Detyra   | 0            | 0                        | 0                            |
| Gjysmë finale  | 1            | 0                        | 0                            |
| Provimi final  | 1            | 7                        | 7                            |
| Të tjera   | 0            | 0                        | 0                            |
| <b>Ngarkesa totale e orëve</b>   |              |                          | <b>127</b>                   |
| <b>Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)</b>  |              |                          | <b>5.08</b>                  |
| <b>ECTS</b>  |              |                          | <b>5.00</b>                  |